



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

Datë:	05.05.2016
Për:	z.Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	Fitim Selimi- Nënkyetar i pare
Nga:	Feti Krasniqi- Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe zhvillim rural
Lënda:	Raporti mujor i aktiviteteve për muajin : Prillë - 2016

Shtojcë: Plani mujor i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural

Gjatë periudhes raportuese DBPZHR , ka mbajtur takime pune me palet e interesit, komunitetin e Fermerëve dhe kemi diskutuar plane zhvillimore me interes për Komunën në përgjithësi.

- DBPZHR, ka vazhduar me pranim të kërkesave për mbështetje në disa propozim projekte për subvencionim në pagesat direkte.
- Po ashtu janë pranuar te gjitha aplikacionet , për subvencione komunale sipas fteses per aplikim te publikuar ne faqen zyrtare te komunes se Lipjanit më:31.03.2016
- I gjithë dokumentacioni eshte pranuar dhe përpunuar ne dosjet e DBPZHR.

Gjatë periudhës raportuese DBPZHR , ka përcjellur gjendjen e kulturave bujqësore në teren .Nga vlerësimet tona konstatojm se mbjelljet e pranverës janë mbjellur sipas dinamikës si rezultat i kushteve klimatike .

Gjatë periudhes raportuese kemi mbajtur takime pune me Kforin Turk.Ata u interesuan per zhvillimet ne sektorin e bujqesise dhe pas diskutimeve reciproke ata shfaqen gadishmerine per te bashkëpunuar edhe ne te ardhmen ne kete sektor.

Ne kemi identifikuar cilat jane nevojat tona , dhe mundesit e tyre per te na ndihmuar , nder prioritetet e bashkëpunimit mendojm te vendosim projektet tona ne fushen e perimëkultures , ngase ne kete sektor kemi shumë kërkesa per përkrahje.

Gjithashtu gjate muajit Prillë kishim nje takim pune me përfaqësues te Organizates DEMOS, per te vlerësuar bashkarisht rrethe rregullores unike ne fushen e subvencioneve. Ne kete takim ne prezantuam rregulloren tone e cila eshte mjaft e avancuar , por kemi dhene edhe sugjerimet tona per te ardhmen , por e dime qe propozimet duhet te marrin përkrahjen ne kuvendin komunal.

Gjate këtij muaji kemi patur befasi nga temperaturat e uleta , sidomos ne daten 20.04.2016 , ku edhe jane shenuar deme te konsiderueshme ne plantacionet pemtare , ne llugaxhi.

Pas kërkeses së pronarve të këtyre plantacioneve , në mënyrë të menjhëgjere kemi formuar komisionin për vlerësim , dhe kemi dalë në terren për të bërë vlerësimin e demeve. Pas vlerësimit lenden e kemi rekomanduar për MBPZHR.

Në nivelin komunal me sukses kanë vazhduar trajnimet e fermerëve për segmente të caktuara bujqësore.

Në sektorin e pylltarisë janë zhvilluar këto aktivitete:

- Ka vazhduar revizioni i terreneve pyjore
- Janë nxjerrë rekomandime , për procedim ndaj rojeve të pyllit , varësisht nga niveli i vlerësuar i demëve në terrenet pyjore.
- Raporti i fletëparaqitjeve të demëve pyjore për muajin Prillë 2016
- Orari i seancave gjyqësore komunale për muajin vijues
- Pasqyra e aktgjykimeve gjyqësore për periudhën Janar – Prillë 2016
- Pasqyra e aktgjykimeve-Aktvendimeve gjyqësore për muajin MAJ 2016